

**KLSH merr pjesë në takimin e zhvilluar në kuadër të auditimit të përbashkët me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”.**

Në vijim të angazhimit që KLSH ka ndërmarrë së bashku me SAI-t e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe në bashkëpunim me UN Women Albania për të kryer auditimin e përbashkët me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, në datat 25 dhe 26 maj 2023, u zhvillua në Tiranë takimi rajonal ku morën pjesë grupet e auditimit të secilit SAI si dhe përfaqësues të UN Women nga vendet pjesë e këtij projekti.

Takimi u organizua nga UN Women Albania dhe objektivi kryesor i tij ishte diskutimi ndërmjet grupeve të auditimit për rezultatet paraprake të fazës studimore, me qëllim dakordësimin e drejtimeve të përbashkëta të auditimit.

Në këtë takim KLSH u përfaqësua nga grupi i auditimit, znj. Ermira Vojka, përgjegjëse e grupit të auditimit, dhe znj. Arminda Bushi, anëtare.



Foto: UN Women Albania

Secili grup prezantoi rezultatet e studimit të kryer deri në ato momente. Në prezantimin e bërë nga znj. Vojka u paraqit një panoramë e politikave dhe e kuadrit ligjor dhe rregullativ që ka vendi unë për punësimin e grave. Gjithashtu, u paraqitën edhe fushat me risk që grupi i auditimit ka identifikuar deri në këtë fazë, si rezultat i intervistave të zhvilluara në bashkitë nën auditim dhe shqyrtimit të dokumentacionit të grumbulluar.

Grupet e auditimit, pas prezantimeve të rezultateve paraprake, diskutuan dhe shkëmbyen mendime rreth drejtimeve kryesore dhe qasjes së auditimit. Në këto diskutime u përfshinë edhe ekspertët e UN Women të cilët dhanë sugjerimet e tyre lidhur me drejtimit që mund të përfshijë auditimi.



Foto: UN Women Albania

Në fund të takimit, specialistja e Programit në UN Women, për Evropën dhe Azinë Qendrore znj. Ermira Lubani, duke vlerësuar punën e prezantuar nga grupet e auditimit, theksoi rolin e rëndësishëm që kanë Institucionet Supreme të Auditimit në rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike për fuqizimin ekonomik të grave në rajon.

Gjithashtu, znj. Lubani prezantoi disa nga planet e UN Women për angazhimet e ardhshme në fushën e auditimit me perspektivë gjinore për të cilat do të kërkohet edhe bashkëpunimi me Institucionet Supreme të Auditimit.

Në përfundim, grupet e auditimit dhe pjesëmarrësit u dakordësuan në parim për vijimësinë e punës deri në takimin e ardhshëm.